



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-117
Prishtinë, më 07 shtator 2010, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 07 SHTATOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, dhe Numan Baliq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli, Branislav Gerbiç dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga ZCN: Blerta Bejtullahu
Nga OSBE: Lejla Selimi dhe
Nga NDI, Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur 31 gusht 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 31 gusht 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 gusht 2010, u miratuar pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhjet e Kuvendit të mbahet me 15 dhe 16 shtator 2010, dhe atë:

Më 15 shtator 2010 me këtë

R e n d d i t e:

1. Mocioni i Grupit parlamentar të LDD-së për debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të PTK-së.

Më 16 shtator 2010 me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Konfliktet Administrative,
4. Strategjia dhe Propozim Vendimi i Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-së,

5. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, me kërkesë të deputetit Emrush Xhemajli, i mbështetur edhe nga disa deputetë të tjerë.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për Propozimin e Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e Guvernatorit të BQK-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit i sugjeron Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës që rekomandimin, për shkarkimin e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ta bënë mbi bazën e Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve të Republikës së Kosovës 2011-2013

Kryesia, pasi shqyrtoi Kornizën afatmesme të shpenzimeve të Republikës së Kosovës 2011-2013, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, që ta shqyrtojë Kornizën afatmesme të shpenzimeve të Republikës së Kosovës 2011-2013, dhe Kuvendit ti paraqet Raportin me Rekomandime.

3.2 Raporti vjetor i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, për vitin financiar 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi Raportin vjetor të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, për vitin financiar 2009, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që ta shqyrtojë Raportin vjetor të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, për vitin financiar 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.3 Propozim-vendimi i Kryeministrit të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së pronës dhe të zëvendës drejtorit të Sekretarisë ekzekutive

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e Kryeministrit të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së pronës dhe të zëvendës drejtorit të Sekretarisë ekzekutive, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për legjislacion dhe Gjyqësi që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Kryeministrit të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së pronës dhe të zëvendës drejtorit të Sekretarisë ekzekutive, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.4 Kërkesa e Komisionit për Punë të Brendshme për lejimin e udhëtimit në Hungari, si dhe kompensimin e mëditjeve

Kryesia, pasi shqyrtoi Kërkesën e Komisionit për Punë të Brendshme për lejimin e udhëtimit në Hungari, si dhe kompensimin e mëditjeve, nxori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri në Hungari, prej 12 deri më 17 shtator 2010, në përbërje: Rustem Mustafa, Radmila Vujoviq, Suzana Novoberdaliu, Basri Musmurati, Ismet Beqiri, Shkumbin Demaliaj, Zylfi Merxha dhe Eqrem Kryeziu, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj dhe Blerina Pula.
2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i bart organizatori, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03-V-094.

3.5 Kërkesa e Komisionit për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për lejimin e udhëtimit në Zvicër, si dhe kompensimin e mëditjeve dhe shpenzimet e udhëtimit

Kryesia, pasi shqyrtoi Kërkesa e Komisionit për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për lejimin e udhëtimit në Zvicër, si dhe kompensimin e mëditjeve dhe shpenzimet e udhëtimit, nxori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Zvicër, prej 10 deri më 14 shtator 2010, në përbërje: Sadik Idriz, Flora Brovina, Nurisha Hula, Qamile Morina dhe Emrush Xhemajli.

2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i bart organizatori, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03-V-094.

3.6 Kërkesa e OJQ “Handi-KOS” për mbajtjen e një ekspozite në hollin e ndërtesës së Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e OJQ “Handi-KOS” për mbajtjen e një ekspozite në hollin e ndërtesës së Kuvendit, vendosi që mos të lejohet mbajtja e ekspozitës në hollin e ndërtesës së Kuvendit.

.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 14:00.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale